FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS

Raporti i Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025



Përmbajtja	**Faqe**
Raporti i Auditorit të Pavarur	3-4
Pasqyra e burimit dhe përdorimit të fondeve	5
Pasqyra e pozitës financiare	6
Pasqyra e ndryshimeve në bilancin e fondeve	7
Pasqyra e rrjedhjes së arkës	8
Shënime për pasqyrat financiare	9-18

Quatra
AUDIT | TAX | ADVISORY
A:Str. Nena Tereza, H2-1
T: +383 (0) 44 377-873
E: lulzimkraniqi@gmail.com
W: www.quatra-ks.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin dhe Menaxhmentin e Federatës së Gjimnastikës së Kosovës
Ne kemi audituar Pasqyrën e bashkangjitur të burimeve të fondeve dhe përdorimit të tyre dhe Pasqyrën e pozitës financiare ("Pasqyrat") të "Federatës së Gjimnastikës së Kosovës" ("FGJK") si dhe një përmbledhje të politikave kontabël dhe shënimeve tjera shpjeguese për vitin që ka përfunduar me 31 dhjetor 2025.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të hyrat e mbledhura dhe shpenzimet e paguara nga Federata e Gjimnastikës e Kosovës, poziten financiare si dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025, në përputhje me Politikat e kontabilitetit të sqaruara në pikën 2.

Baza për Opinionin
Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga FGJK-ja në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Raportimit Financiar të zbatueshme në Kosovë, me Politikat e sqaruara në pikën 2 dhe për ato kontrolle të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e FGJK-së për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë FGJK-në ose të ndërpres aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të FGJK-së.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të përftojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyra e pranimeve dhe disbursimeve si tërësi nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomalitë mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.
Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojmë evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të FGJK-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrës së pranimeve dhe disbursimeve, përfshirë shpalosjet, dhe nëse pasqyra e pranimeve dhe disbursimeve përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet themelore në një mënyrë që arrin prezantimin e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënëse të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm të identifikuara gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasniqi, Auditor Ligjor, CBV, CertIFR, LREV
Partner, QUATRA AUDIT Int. LLC

P: +383 (0) 44 377 873 ◇ E: lulzimkrasniqi@gmail.com
A: Sheshi Nëna Terezë, H1, Nr.2, Prishtinë, Kosovë
Licenca KKRF Nr. 80 ◇ Nr. Scaak: 2088

Prishtinë, 17 korrik 2026

Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar Quatra Audit Int Prishtinë

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS

PASQYRA E BURIMIT DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025
(Shumat ne Euro)

	Shënime	2025	2024
Të hyrat nga MKRS	3	87,690	115,785
Të hyrat tjera	3	2,730	-
Gjithsej të hyrat		**90,420**	**115,785**
Shpenzimet për paga dhe meditje	4	-16,540	-26,385
Shpenzimet administrative dhe operative	5	-23,050	-9,109
Shpenzimet për antaresi kuotizim dhe pjesëmarrje	6	-10,759	-17,264
Shpenzimet për transport dhe udhëtim	7	-51,324	-45,331
Shpenzimet për organizim të garave	8	-12,708	-1,372
Shpenzimet për shpërblime dhe klube rajonale	9	-3,109	-15,382
Gjithsej shpenzimet		**-117,490**	**-114,843**
Teprica/Mungesa e fondeve të mbetura		**-27,070**	**942**

Raporti financiar është aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti i OJQ-së më datë 29 maj 2026.

Shkumbin Maqastena
Drejtor

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTIC FEDERATION
FGJK - KGF

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE
Më 31 dhjetor 2025
(Shumat ne Euro)

	Shënime	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
PASURITË			
Paraja e gatshme	10	741	15,290
Pasuri rrjedhës të tjera		-	-
GJITHSEJT PASURITË		**741**	**15,290**
FONDET DHE DETYRIMET			
Detyrimet			
Detyrimet afatshkurtëra	11	13,714	1,212
Tatimet të pagueshme	12	138	118
Gjithsej detyrimet		**13,851**	**1,331**
Fondet			
Teprica(mungesa) e akumuluar		-13,111	13,959
Gjithsej fondet		**-13,111**	**13,959**
GJITHSEJT FONDET DHE DETYRIMET		**741**	**15,290**

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË BILANCIN E FONDEVE
Për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025
(Shumat në Euro)

	Bilanci i Fondeve	Total
Bilanci me 01 janar 2024	**13,017**	**13,017**
Teprica (Mungesa) e fondeve gjate vitit	942	942
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Bilanci me 31 dhjetor 2024	**13,959**	**13,959**
Bilanci me 01 janar 2025	**13,959**	**13,959**
Teprica (Mungesa) e fondeve gjate vitit	(27,070)	(27,070)
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse	-	-
Bilanci me 31 dhjetor 2025	**(13,111)**	**(13,111)**

	2025	2024
Teprica (Mungesa) e fondeve e vitit	(27,070)	942
Korrigjimet:	-	-
Fitimi para ndryshimit ne asetet dhe obligimet operative	**(27,070)**	**942**
(Rritja)/Zvogëlimi ne llogaritë e arkëtueshme	-	-
Rritja/(Zvogëlimi) ne llogaritë e pagueshme	12,501	(2,990)
Rritja /(Zvogëlimi) në detyrimet tjera	19	(636)
Paraja e përdorur në operacionet	**12,520**	**(3,626)**
Neto rritja e parasë dhe ekuivalentëve	**(14,549)**	**(2,683)**
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	15,290	17,973
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit	**741**	**15,290**

Shënimet shoqëruese nga 3 deri 14 janë pjesë integraletë pasqyrave financiare

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Federatës e Gjimnastikës e Kosovës – FGJK (tutje e njohur si "Federata") është Organizatë joqeveritare, regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike me numër të regjistrimit 5114560-7 dhe numër fiskal 601012199. FGJK veprimtarinë e vet e ka filluar në fillim të vitit 2013. Selia e FGJK është në Prishtinë. Është licencuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit me datën 29 Janar 2014 me numër licence 26/2014.

Federata e Gjimnastikës e Kosovës me datë 30 Tetor 2014 është pranuar nga Federata Ndërkombëtare e Gjimnastikës FIG në Tashken të Uzbekistanit ndërsa me 21 Nëntor 2015 ajo u pranua edhe nga Unioni Europian i Gjimnastikës në kongresin e mbajtur në Bratisllavë të Sllovakisë.

Qëllimi i organizatës është mbajtja e kontinuitetit, rritjes dhe cilësisë si brenda klubeve po ashtu edhe konkurrencës në nivel vendi.

Për t'i përmbushur qëllimet e saj, organizata do të ndërmarrë, por nuk do të kufizohet vetë kufizohet vetëm në to, aktivitetet e poashtëshënuara:

a) Promovimin dhe masivizimin e sportit të Gjimnastikës në vazhdimësi,
b) Infrastruktura, sallat dhe veglat e gjimnastikës,
c) Trajnimi dhe licencimi i Trajnerëve dhe Gjyqtarëve,
d) Harmonizimi i programit stërvitor nacional me atë të FIG-ut,
e) Përgaditja për pjesëmarrje në ngjarjet sportive ndërkombëtare,
f) Organizimi i garave me karakter vendor ndërkombëtar.

2. Politikat e kontabilitetit

Pasqyra financiare janë përgatitur për qëllime të raportimit tek Divizioni i Raportimit Financiar i OJQ-ve në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike.
Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1. Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhje me dispozitat e raportimit financiar të Nenit 18 të Ligjit Nr. 03/L-134 për Lirinë e Asocimit në Organizata Joqeveritare si dhe janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Mbi këtë bazë të raportimit Federata e Gjimnastikës e Kosovës së Kosovës duhet të raportojë fondet dhe përdorimin e tyre gjatë periudhës dhe pasuritë dhe përgjegjësitë financiare të saj (neni 18, pika 6 e ligjit Nr. 03/L-134)Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmeri me konventën e kostos historike. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për vitin e përfunduar aktual dhe periudhen paraprake. Të dhënat aktuale dhe karahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro, përderisa nuk ceket ndryshe. Kur është e nevojshme zërat krahasues janë harmonizuar konform ndryshimeve të vitit në prezantim.

2.2. Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.3. Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.4. Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

2.5. Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

2.6. Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Federatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

2.7. Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlerësimi është ngarkuar duke përdorur metodën lineare në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

	2025	2024
Mobiljet dhe paisjet	2-5 vite	2-5 vite
Paisjet e TI nën 1,000 Euro	3 vite	3 vite
Veturat	5 vite	5 vite

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtatshme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Federatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.8. Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluara nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njejta përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.
Pasuritë e pa prekshme të Federatës përmbajnë Softuerë kompjuterik.
Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

2.9. Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Federata i njeh si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompenzim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Federata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:
- Federata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënjuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.10. Stoqet

Stoqet janë prezantuar me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe çmimit të shitjes minus kostot e kompletimit dhe shitjes.

2.11. Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Shumica e shitjeve janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Ku kreditimi është zgjatur përtej afateve normale të kreditimit, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të arëktueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

2.12. Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

2.13. Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe përfshihen në shpenzimet financiare.

2.14. Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.15. Benefitet e të punësuarve

Federata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shtesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Federata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.16. Tatimi në fitim

Federata është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e liruar nga tatimi në të ardhura të korporatave. Federata gjatë vitit aktual raportues nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Federata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimore gjatë vitit aktual, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

3. Të hyrat

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
Të hyrat nga MKRS	87,690	115,785
Të hyrat nga KOK	2,730	-
Gjithsej	**90,420**	**115,785**

Të hyrat nga MKRS në shumë prej 87,690 Euro në vitin 2025 respektivisht 115,785 Euro të pranuara në vitin 2024 nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit bazuar në Memorandumin e Mirëkuptimit me qëllim të mbështetjes financiare të FGJK-së në realizimin e objektivave dhe synimeve të saj.

4. Shpenzimet e personelit

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
Pagat dhe mëditjet bruto	15,590	25,152
Kontributet pensionale të punëdhënësit	950	1,233
Gjithsej	**16,540**	**26,385**

5. Shpenzimet administrative dhe operative

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
Shpenzimet e auditimit	700	700
Shpenzimet e derivateve	1,245	2,411
Shpenzimet e Internetit & tel.	179	668
Shpenzimet e konsulences	2,250	1,800
Shpenzimet e pajisjeve te vogla	17,335	1,190
Shpenzimet e tarifave bankare	702	736
Shpenzimet tjera ADM&oper.	637	1,604
Gjithsej	**23,050**	**9,109**

6. Shpenzimet për antaresi kuotizim dhe pjesëmarrje

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
Kuotizim	300	300
Membership fee	1,780	1,800
Participation fee	8,679	15,164
Gjithsej	**10,759**	**17,264**

7. Shpenzimet për transport dhe udhëtim

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
Air bileta	9,099	6,134
Transport rrugor	16,466	9,035
Shp. per ushq. pije dhe akomod.	24,776	29,953
Të tjera	983	210
Gjithsej	**51,324**	**45,331**

8. Shpenzimet për organizim të garave

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
Qira	3,810	848
Shpenzimet e zerimit	528	500
Të tjera organizim	8,370	24
Gjithsej	**12,708**	**1,372**

9. Shpenzimet për shpërblime dhe klube rajonale

	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2025	për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2024
Kupa Medalje Banera Flyer Dresa	3,109	7,432
Shpenzime per pjesëmarrje në gara	-	6,850
Shpenzimet per klubet rajonale	-	1,100
Gjithsej	**3,109**	**15,382**

Shpenzimet e shpërblimeve janë shpenzime në lidhje blerjet për kupa dhe medalje për mbajtjen e garave të ndryshme.

10. Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Mjete monetare dhe ekuivalente me to më 31 dhjetor 2025 janë si me poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Paraja në arkë	-	-
Paraja në bankë -BEK	741	15,290
Gjithsej	**741**	**15,290**

11. Detyrimet afatshkurtra

Detyrimet afatshkurtëra me datë 31 dhjetor 2025 janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
B FINANCIAL SHPK	600	450
BICI-COM	160	160
NIGHT DESIGN STUDIO SHPK	1,714	89
POWER SOUND NTSH	100	100
VLERA SPORT	623	-
ADRIATIKU DPH	300	-
BENI REISEN	200	-
DRITI DESIGN 2025 SHPK	2,800	-
HOTEL SIRIUS	338	-
KOMITETI OLIMPIK I KOSOVES	300	-
PALLATI I RINISE NPL	1,270	-
SIGAL UNIQA	21	-
STAR TECH SHPK	1,675	-
TELEKOMI I KOSOVES SHA	38	-
VILLA PIKNIKU DPH	248	-
Huazim afatshkurtër - KOK	1,500	
Detyrimet ndaj pagave	1,827	414
Gjithsej	**13,714**	**1,212**

12. Tatimet të pagueshme

Tatimet të pagueshme me datë 31 dhjetor 2025 janë paraqitur si më poshtë:

	31 dhjetor 2025	31 dhjetor 2024
Kontribute pensionale	100	90
Tatimi në paga	38	28
Gjithsej	**138**	**118**

13. Zotimet dhe kontigjencat

Zotimet dhe Çështjet gjygjësore

Nuk ka zotime me 31 dhjetor 2025. Federata nuk paguan qera pasi shfrytëzon zyren në hapsirat e Federatave të Kosovës.
Me 31 dhjetor 2025 nuk është llogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjygjësore. Menaxhmenti i FGJK-së, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjygjësore dhe predendimet e mundshme kundër FGJK-së, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çshtjeve nuk mundet gjithëmonë të saktësohet, menaxhmenti i FGJK-së beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

14. Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.